

Virtytet

Autorët e vjetër jepnin pes virtyte të stilit: korrektesën ose **puritetin** e gjuhës, **qartsinë**, **evidencën**, **etiketën** (dekorin) ose mungesën e vulgaritetit, dhe **estetikën** ose artin e të shkruomit. Këto koncepte mbeten relativisht të qëndrueshme.

Virtytet mbesin të tilla vetëm përderisa ato nuk teprohen, përndryshe ato kthehen në vese. Për shembull, fjala angleze 'email' është e nevojshme (virtyt), kurse fjala 'uikend' është e panevojshme (ves).

1. Korrektesa ose Puriteti i Gjuhës

Me korrektesë këtu kihet parasysht ose standardi zyrtar ose norma letrare. I pari mjafton për nxanësit e shkollave dhe lexuesit e thjeshtë, sepse këtu autorit i kërkohet rregullave gramatikore të gjuhës. I dyti është më i avancuom. Tipikisht, norma u shërben atyne që jepen pas letërsisë, veçsisht të së ashtuquajturës *letërsi e nëltë*. Për shembull, pa njohë pak gjuhën e normës letrare, është e vështirë me kuptua dhe analizua vepra si *Vaji i Bylbylit* e Mjedjes ose *Shkundullima*, *Karpa*, e *Rrathët* të Camajit.

Devijimi prej fjalëve korrekte

Devijimi prej kuptimit të fjalës që jep fjalori është virtyt kur ky devijim nevojitet me përmirsua kumtin; në të kundërtën ai është ves.

Metaplazma

grc. μεταπλασμός < μετά μετά + πλάσσω plássō (me formua, me i dhanë trajtë ose formë)

Kjo figurë retorike ndahet në katër kartegori:

1. shtimi: *epenteza, paragoga, proteza, diareza, etj.*
2. hjekja: *apokopa, elipsa, sinareza (synaeresis), synkopa, etj.*
3. transpozimi i germave se rrokjeve: *metateza*
4. zëvendësimi: *antisthekon*

a) Metaplazma. Përmirsimi i kumtit

Shtimi. Rapsodët e MM shtonin tingullin /ë/ kur ai kërkohet me ruajt balancën tingullore të vargut, p.sh., kur, në krahasim me vargjet tjera, një vargu i mungonte një zanore.

Heqja. Në vargun e parë të *Iliadës*, Nikoll Dakaj heqë disa germa me përkua rrokjet e vargjeve:

Mnin, rrenimtare këndomë, oj Zan' ti t' Akil Pelejas

(Mëninë rrenimtare, këndomë oj Zanë ti të Akilit Pelejas)

a) Metaplazma. Gandimi i kumtit

shtim: në vend të 'atberë' mund të përdoret 'atberna' (MM).

heqje: në vend të 'shtëpi' mund të përdoret 'shpi'.

transpozim: lëvizë > vëlizë; film > slim

zëvendësim: Tirana > Tirona

Barbarizmat

a) *Barbarizmat*. Përmirsimi i kumtit

Fjalë të huaja që ndihmojnë kumtin janë shumica e fjalëve tradicionale greke e romake, p.sh., *abstrakt, koncept, deduksion, logos*, e të tjera.

a) *Barbarizmat*. Gandimi i kumtit

Fjalët e huaja që zëvendsojnë fjalët shqipe janë barbarizma, p.sh.,

shqip: *kryesí, kryetar, Flamurtar, Avë, ajkë/ajth, kopësht*

barbarizma: *başkí, bashkiak, bajraktar, spirit/ymër, esencë, bahçe*

b) *Renditja*. Kjo lidhet me devijimin artplotë të rendit të fjalëve, tipikisht përdorimin e skemave (shih më poshtë).

Devijime negative

a) *Metaplazma*

rana > rona

Ndërrimi a > o nuk është as negativ as pozitiv; është të folun në dialekt. Por, sipas stilistëve, të cilët ngulmojnë që shkruesi e ligjruesi duhet të përdorin gjuhën standarde / normën letrare, dialektizmat merren si negative.

Devijimi prej rendit korrekt

Përdorimi i skemave e tropeve mund të jetë virtyt kur bahet me mjeshtrí, por mund të tregojë edhe mungesë kompetence kur autori nuk e kupton që ai po devijon.

Solecizmi

σολοικισμός soloikismós) < σόλοικος sóloikos (me folë jokorrektisht).

Solecizmi është një figurë gramatike që përkufizohet si një e folun të korruptuome—në sensin e devijimit prej një dialekti, standardi, ose norme. Në terma më praktike, solecizmi nënkupton devijim prej gramatikës konvencionale, dhe mund të gjindet në secilën prej katër kategorive të ndërrimit (*shtimit, hjekjes, transpozimit, dhe zëvendësimit*), p.sh.,

errtim: *Nuk erdhi askush. Shtyni derës.*

korrektim: *Nuk erdhi kush. Shtyni derën.*

Skemat

Përdorimet gandore të skemave mund të lidhen me, ‘*balancën, ndërrimin e rendit të fjalëve, elipsën, përsëritjen*, etj. Por, devijimet duhen dallua prej errtimeve. Skemat devijojnë prej gramatikës me cak theksimin e një koncepti, por ato nuk thejnë rregullat gramatikore, p.sh., rendi normal i shqipes është KFKn.

KFKn: **Shtojza** shtyni derën.

KnFK: **Derën** e shtyni Shtojza.

FKnK: **Shtyni** derën Shtojza.

Kur këto ndryshime përkojnë me cakun e theksimit, ato nuk janë gabime. Por, kur ato ndodhin prej mungesës së kompetencës gramatikore, ato janë gabime, të cilat, tipikisht gjinden ndër folës që po mësojnë një gjuhë.

2. Qartsia

Qartsia është e evidente kur kumti kuptohet lehtëzi, p.sh., kur fjala përdoret me kuptim të drejtë dhe vendoset aty ku duhet. Por, kur kuptimi i fjalës nuk i përshtatet përdorimit të saj ose kur fjala vendoset aty ku nuk duhet, kumti nuk kuptohet, domethanë është i paqartë.

a) Specificiteti ndihmon qartsinë:

Në kurt të mikut të tij, ai pa një mercedes të zj.

Jo makinë, veturë, veturë të shtrenjtë—veçsish jo: *veturë ekspensive*. Por edhe specificiteti mund të kthehet në ves, p.sh., *mercedes të zj S 550, tet pistonësh*. Megjithatë, ka edhe herë kur specificimet i shërbejnë tekstit, p.sh., një personazh tejet energjik mund të ketë një *mercedes 12 pistonësh* spese ky pronsim i përshtatet natyrës së tij. Por, tipikisht, specificimi i teprouom është ves.

b) Rendi i gabuom i fjalëve krijon paqartsí:

Ai pá makinën e mikut të tij duke shkua në qytet.

Kush po shkonte në qytet, ai apo makina?

Ai e pa Filen në tren.

Kush ishte në tren, ai apo Filja?

Ndërsa po darkonte me Davën, Filja i tha Prelës...

Kush po darkonte me Davën?

3. Evidenca

la. evidencia (qartsí); në latinishten e vonë: provë < evidens (qartë). Prej këndeje, fjalia *Ësht evidente*, do të thotë *Ësht e qartë*.

Evidenca egziston në vetvete dhe për vetvete; por është e shqisueshme prej njeriut. Ajo mund të përdoret sëpaku në dy mënyra,

- a) me krijua një përshkrim të gjallë
- b) si evidencë me mbështetë një argument.

Mënyra a) lidhet me emocionet e audiencës; përçimin e kumtit në një mënyrë që përmbajtja të mund të imagjinohet lehtë. Kur imagjinata nxitet, ndjenjat ndezen. Prandaj, kur caku i kumtit është emotiv, përshkrimi shqisor është thalbsor. Me ‘shqisor’ nënkuptohet çka mund të *shihet, dëgjohet, nuhatet, shijohet, preket*. Për disa edhe *peshohet*.

Përveç figurave përshkruese (enargeia), ky tip evidence mund të përfitojë edhe prej përdorimit të figurave si *zmadhimi* (amplifikimi), *zvogëlimi*, *klimaksi*, *divizioni*, e të tjera.

Mënyra b) lidhet me bindjen. Edhe këtu përshkrimi duhet të jetë sa më i gjallë, por qëllimi ndryshon sepse këtu caku i kumtit lidhet me aftsinë arsyetuese të audiencës, jo emocionet.

4. Etiketa (decorum)

Në gjuhën e përditëshme thohet ‘Duhet me u sjellë si duhet’, domethanë, duhet me u sjellë në përkim me parimet morale të pranuar prej një shoqnie. Ky parim përfshin edhe veprat e shkruara.

Etiketa (dekori) diktton që fjalët duhet t’i pershtaten *subjektit* të kumtit, *audiencës*, *situatës*, *kohës*, e të tjera. Audiencia e ndjen intuitivisht nëse kumti i autorit është fyes, asnjëanës, apo i respektueshëm. Megjithatë, etiketa nuk duhet ngatërrua me tonin; qëndrimin e autorit ndaj subjektit të veprës.

Autori që e analizon një çashtje thellsisht, nuk ka nevojë me shkrua vulgarizma. Prandaj, mungesa e dekorit/etiketës mund të si tregues i mungesës së kompetencës.

Dekori është kontekstual (rrethor). Ai kërkon njohje dhe sensitivitet ndaj gjuhës, estetikës, moralit, dhe etiketës së vendit dhe kohës kur vepra i ofrohet publikut. Që vepra të bëhet pjesë e diskursit publik ajo duhet të jetë e randësishme intelektualisht, por edhe jofyese. Ashtu si lexuesit e dëgjuesit, edhe diskursistët e kritikët mund t’a ‘denojnë’ autorin për mosrespektim të etiketës (dekorit). Nuk është fjala për ‘cancel culture’, por për sjellje të denjë, pjesë e të cilës janë edhe ligjratat e shkrimi.

5. Estetika

Për disa stili përkufizohet si përdorim i sofistikuum i figurave letrare. Por ka shkrimtarë shumë të respektuom që nuk i qasin figurat letrare sepse, besojnë ata, ato tingëllojnë si veçsi e shkrimtarëve rioshë, fillestarë, ose manipulues. Megjithatë, Shekspiri pati përdorun çdo figurë letrare që ai njihëte.

Estetika i ngjan qartsisë sepse të dyja shqyrtojnë nuancimet kuptimore të fjalëve dhe rendin e fjalëve në fjalí. Prandaj, për një pjesë të audiencës, leximi mund të vështirsohet kur autori dobison *fjalë të vjetra, dialektizma, huazime të reja, përdorimin e tepruom të figurave letrare*, e të tjera. Mund të shihet sesi estetika mund të kalojë krejt lehtëazi në ves.

Estetika i ngjan edhe prezantimit sepse të dyja dobisojnë tingëllimën dhe ritmin e gjuhës. Edhe këtu mund të kalohet në ves kur prezantuesi, me cak argëtimin e audiencës, e tepron me përdorimin e figurave letrare, dhe kështu mund të ndërhyjë me qartsinë e kumtit.